



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 06/11

Prishtinë, më 30.03.2011, ora 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Munguan: Naser Osmani dhe Xhevdet Neziraj

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza-Ministër i Financave, Agim Krasniqi - Drejtor i Buxhetit, Alexander Beetz, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ, si dhe monitorues nga Zyra e Presidentit dhe KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i raportit me rekomandime për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i raportit me rekomandime për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011

Kryetarja, tregoi që me nenin 24.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike konstatohet që të gjitha shpenzimet të cilat janë bërë gjatë muajve të kaluar (janar, shkurt dhe mars) konsiderohen si pjesë e buxhetit për vitin 2011 dhe këtë sqarim duhet ta japim edhe në Ligjin për Buxhetin. Propozoi që për këtë qëllim të shtohet një amendament i ri 7, me tekstin si në vijim:

Neni 19

Shpenzimet e ndodhura në mungesë të Ligjit për Ndarjet Buxhetore

Të gjitha shpenzimet e ndodhura deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, konsiderohen pjesë e këtij ligji në pajtim me nenin 24.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048. (Në vazhdim bëhet rirenditja e neneve).

Shtimi i Amendamentit 7 me riformulimin e lartpërmendur, u përkrah njëzëri.

Agim Krasniqi, tha që në mbledhjen e kaluar është propozuar një nen i veçantë për çështjen e punësimit të qëndrueshëm. Pas konsultimeve me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Arsimit është konstatuar që nuk ka nevojë të hapen linja të veçanta buxhetore për arsye se punësimi i qëndrueshëm është brenda programeve ekzistuese të Ministrisë së Arsimit që ka të bëjë me trajnime të ndryshme dhe te Ministria e Punës që ka të bëjë me punësim është Divizioni për Punësim. Prandaj nenin që është propozuar nga Ministria e Financave dhe përkrahur nga Komisioni, për punësimin e qëndrueshëm, propozojë që të fshihet.

Propozimi i Ministrisë së Financave për fshirjen e nenin që rregullon çështjen e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore për punësimin e qëndrueshëm, u përkrah njëzëri.

Kryetarja, lexoi amendamentin 25 të propozuar nga Ministria e Financave që ka të bëjë me shkurtimet buxhetore për mbulimin e kërkesave shtesë të aprovuara nga komisioni.

Hykmete Bajrami, kërkoi një sqarim nga Drejtori i Buxhetit lidhur me kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve për ATK-në dhe Doganat që janë zvogëluar, çka do të thotë kjo, a kanë pasur ata mjete të tepërta për paga dhe mëditje? Dhe një vërejtje për Ministrinë e Infrastrukturës kodi 205 Programi i Mirëmbajtjes së Rrugëve, nëse është fjala për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit, ku komunat janë ankuar se nuk ka fonde të mjaftueshme, pyeti a ka qenë kjo alternativa më e mirë për ta shkurtuar këtë buxhet edhe ashtu të kufizuar?

Agim Krasniqi, sqaroi si parim që asnjë organizatë buxhetore nuk ka pasur mjete të tepërta për kategorinë e pagave, por është dashur të ndërhyjmë dhe të ATK-ja dhe Dogana për shkak se ata janë në përgatitje të një sistemi të ri të pagave si dhe në ATK po priten të fillojnë punës edhe disa punëtorë të ri dhe kemi menduar që është më lehtë që të ndërhyjmë në dy organizata të Ministrisë së Financave, sepse të kemi probleme me të gjuha organizatat. Sa i përket çështjes së Mirëmbajtjes së Rrugëve, ai theksoi se është fjala edhe për mirëmbajtjen verore edhe për atë dimërore për të cilën përgjigjet Ministria e Infrastrukturës. Kemi qenë në mes të të kësaj kategorie dhe barnave, dhe kemi menduar që më mirë është t'i shkurtojmë mjetet në mirëmbajtjen e rrugëve.

Pas diskutimeve, Komisioni, me shtatë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Hasime Krasniqi, Jelena Bontic, Duda Balje, Muhamet Mustafa, Latif Gashi, Sali Asllanaj) dhe dy Kundër (Albana Fetoshi dhe Hykmete Bajrami) nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet propozim-amendamentin 25 të propozuar nga Ministria e Financave, për shkurtime të buxhetore, për mbulimin e kërkesave buxhetore shtesë, të aprovuara nga Komisioni.

Në vazhdim u përkrah propozim-amendamenti i Ministrisë së Financave për ndryshime të projekteve kapitale brenda buxhetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Anëtarët gjithashtu u pajtuan që të bëhet, një rregullim i brendshëm për investime kapitale, brenda buxhetit të Kuvendit (në pjesën e amendamentit për Kuvendit).

Agim Krasniqi, me qenë se Komisioni ka vendosur që buxheti i RTK-së për vitin 2011, të transferohet në kuadër të buxhetit të Kuvendit, kërkojë përmes amendamenteve, të rregullohet që buxheti i RTK-së, në tabelat buxhetore të figurojë vetëm për vitin 2011.

Hykmete Bajrami, propozoi që në amendamentin 17, pika 7, në pjesën ku rregullohet buxheti i RTK-së, në fund të shtohet teksti, “vetëm për vitin 2011”.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, përkrahu propozimin e Deputetes Hykmete Bajrami, për shtimin e tekstit “vetëm për vitin 2011”, në amendamentin 17, pika 7 (i cili bëhet amendamenti 18).

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Hasime Krasniqi, Jelena Bontic, Duda Balje, Muhamet Mustafa, Latif Gashi, Sali Asllanaj dhe Hykmete Bajrami), një Kundër (Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011. Raporti me amendamentet e propozuara procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ